

VENDIM
Nr.763, datë 11.6.2009

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.80, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE TË MBROJTJES SOCIALE DHE TË
PLANIT TË VEPRIMIT, PËR ZBATIMIN E SAJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjes Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.80, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:
a) Në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale, që i bashkëlidhen vendimit, pas kapitullit 6 shtohet kapitulli 7, me titull “Dokumenti i politikave ndërsektoriale për moshën e tretë”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në planin e veprimit të strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet aneksi nr.2, me titull “Plani i veprimit për politikën ndërsektoriale të moshës së tretë, për periudhën 2009-2013”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë

Ndërsektorial Zhvillues të Moshimit një dimension gjithëpërfshirës.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të konsultuar për këtë qëllim janë organizatat joqeveritare: ASET, Qendra për Gratë dhe Vajzat- Kombin, Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale, Shoqata e Pensionistëve, Shoqata Shqiptare e Gerontologji- Geriatri, Shoqata Shqiptare e Demografëve, Shoqata “Për nxitjen e zhvillimit të gerontologjisë”, ASAG, Qendra Komunitare për të Moshuarit, Gruaja Kryefamiljare, si edhe përfaqësues të pushtetit lokal: Bashkia Tiranë/sektori i shërbimeve sociale, njësia bashkiake nr.5, njësia bashkiake nr.2, njësia bashkiake nr.7 etj.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutuan me anëtarët e grupit të punës për përmirësimin e mëtejshëm të dokumentit, në të cilin vlerësohej përfshirja e sa më shumë institucioneve përgjegjëse në zbatimin e planeve të veprimit të sugjeruara nga ky dokument, si dhe trajtimi i një sërë problemesh sociale si: varfëria, izolimi, shërbimet shëndetësore, solidariteti ndërmjet brezave, edukimi i brezit të ri, asistencë sociale etj.

Procesi i hartimit të Dokumentit Ndërsektorial Zhvillues ka gjetur miratimin e të gjitha palëve të interesuara në adresimin e problematikës dhe respektimit të të drejtave të të moshuarve në Shqipëri.

Hartimi i Dokumentit Zhvillues Ndërsektorial për Moshimin si një iniciativë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u mbështet nga UNFPA jo vetëm financiarisht, por duke of

